



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.12.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten për në formim fillestar, për ndihmës ligjor, znj. {...}”, (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:56 dhe mbaroi në orën 15:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 3. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 5. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 8. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 6. BIRN.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtim i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten për në formim fillestar, për ndihmës ligjor, znj. {...}”, (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, po deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme. Ju njoftoj që Kryetarja është në një angazhim institucional, znj. Llagami, dhe mbledhja do të drejtohet nga unë, Zëvendëskryetar Ilir Rusi.

Gjithashtu edhe nga zoti Kurushi ende nuk kemi njoftim, dhe nuk është prezent në sallë, në zhvillimin e kësaj mbledhjeje.

Sipas rendit të ditës, po vazhdojmë me pikën e parë të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten për në formim fillestar,

për ndihmës ligjor, znj. {...}”, me relatores znj. Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i paraqet për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin “Për deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten për në formim fillestar, për ndihmës ligjor, znj. {...}”.

Znj. {...} ishte kandidate për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili ndihmës ligjor në kushtet kur është vlerësuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të vendimit nr. 157, datë 04.04.2023, se i plotëson kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, profili “ndihmës ligjor”, sipas nenit 34, pika 6, nenit 53, pika 4, dhe nenit 55, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor, si dhe në kreun V të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”.

Në vijim, kandidatja ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe është përfshirë nga Shkolla e Magjistraturës në listën e renditjes së kandidatëve fitues në Programin e Formimit Fillestar për ndihmës ligjor, viti akademik 2023 – 2024.

Më tej ka vijuar procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës për këtë kandidate. Janë nisur formularët dhe shkresat përkatëse.

Ndërkohë, me datë 30.09.2023, në vijim të procedurës së verifikimit kandidatja ka vënë në dijeni Këshillin në rrugë elektronike, lidhur me dorëheqjen e depozituar pranë Shkollës së Magjistraturës.

Në vijim, kandidatja ka depozituar kërkesë me nr. {...}prot., datë 13.10.2023 përpara Këshillit, kërkesë e cila rezulton t’i jetë drejtuar edhe Shkollës së Magjistraturës.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 08.11.2023, protokolluar në Këshill më datë 09.11.2023, Shkolla e Magjistraturës ka informuar se znj. {...}, kandidate për ndihmës ligjore në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2023 – 2024, ka paraqitur kërkesë për të mos ndjekur këtë program duke hequr dorë nga kjo e drejtë.

Sa më sipër, rezultatet e verifikimit në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës, nuk u bënë objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për shkak të pengesës procedurale të analizuar më poshtë, e cila afektonte vijueshmërinë e kësaj procedure verifikimi.

Sipas pikës 1 të Kreut I, të vendimit 424/2020 parashikohet se qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, etj. Në bazë të pikës 2/ii, ky vendim rregullon procedurat e verifikimit edhe për kandidatin fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit.

Vendimi 424/2020 i Këshillit, në pikën 36 të tij, shprehet se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e verifikimit, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim”.

Neni 29, i Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës parashikon se: “2. Kandidatët për magistratë, kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë dhe për pozicionet në Avokaturën e Shtetit të shpallur fitues nënshkruajnë marrëveshjen e regjistrimit, e cila parashikon të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit përgjatë Programit të Formimit Fillestar. 3. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, kandidati për magistrat, kandidati për ndihmës ligjor dhe për pozicionet në Avokaturën e Shtetit konsiderohet i regjistruar në Shkollën e Magjistraturës, në bazë të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 dhe Anekseve të kësaj Rregulloreje”5. Refuzimi për nënshkrimin e marrëveshjes së regjistrimit, sjell, si pasojë, heqjen nga lista të fituesit dhe humbjen e së drejtës për të filluar dhe ndjekur Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Në këtë rast, Këshilli Drejtues i Shkollës raporton

pranë KLGJ-së, KLP-së dhe Avokaturës së Shtetit, sipas rastit mbi situatën e krijuar....”.

Rezulton se me shkresën nr. {...} prot., datë 08.11.2023, Shkolla e Magjistraturës ka informuar se znj. {...}, kandidatë për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2023 – 2024, ka paraqitur kërkesë për të mos ndjekur këtë program duke hequr dorë nga kjo e drejtë. Gjithashtu u konfirmua se për këtë arsye nuk është lidhur marrëveshja e regjistrimit nga shkolla me kandidatin fitues.

Neni 95 i të Kodit të Procedurave Administrative, pamundësia në objekt apo qëllim parashikon se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

Vlerësimi mbi gjendjen e faktit të krijuar dhe vijimin e procedurave të verifikimit.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore, si më lart cituar, del e qartë se organi publik, i cili zhvillon procedurën, detyrohet të deklarojë përfundimin e saj, në rastin kur konstaton ekzistencën e njërit prej rasteve të parashikuara nga neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë dispozitë përdoren terma ligjorë të përgjithshëm dhe të papërcaktuar siç janë “pamundësia”, “objekti” dhe “qëllimi”, por, të cilat, duke u aplikuar në raste konkrete, qartësojnë dhe përcaktojnë vendimmarrjen e organit publik në lidhje me vazhdimësinë e procedurave, të filluara kryesisht nga ana e tij. Nga ana tjetër, duket i qartë interpretimi se qëllimi i procedurës bëhet i pamundur, në rastin kur kryerja e një veprimi administrativ, ka humbur aktualitetin, për shkak të ndryshimit të rrethanave, të cilat mund të jenë faktike ose ligjore.

Me heqjen dorë nga znj. {...}, nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, ka sjellë si pasojë rënien e shkakut për të cilin kjo procedurë ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i saj nuk ekziston më. Zonja {...} nuk ka më statusin e kandidatit fitues, status për shkak të të cilit ka filluar nga ana e Këshillit procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës. Për pasojë qëllimi i këtij procedimi është bërë i pamundur, çka pas sjell përfundimin e kësaj procedure pa vendim përfundimtar.

Deklarimi i përfunduar i procedurës, nuk zgjidh themelin e çështjes, fakt i cili nuk pengon fillimin kryesisht të procedurës apo me kërkesë të palës së interesuar, në kuadër

të një procedure tjetër, me objekt dhe qëllim të përcaktuar në ligj.

Sa më sipër, procedura e verifikimit ndaj znj. {...}, duhet të deklarohet e përfunduar, për arsye se ajo nuk gëzon më statusin e kandidatit fitues, mbi bazën e të cilit ka filluar procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga ana e Këshillit.

Në këto kushte, pasi është shqyrtuar edhe nga Komisioni në mbledhjen e datës 22.11.2023, i paraqitet për miratim mbledhjes plenare projektvendimi si më poshtë: Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten për në formim fillestar, për ndihmës ligjor, znj. {...}.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten për në formim fillestar, për ndihmës ligjor, znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidates znj. {...}, të filluar me vendimin nr. 473,

datë 07.09.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.

2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.12.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, (relatore znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:56 dhe mbaroi në orën 15:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte EWMI.

6. BIRN.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, (relatore znj. Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhje plenare, sikundër e bëra me dije në momentin e fillimit, zoti Kurushi për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitet në këtë mbledhje, tani dhe në vijim të saj.

Njëkohësisht, duke referuar dhe veprimtarisë të ditës së sotme të Komisioneve të këtij Këshilli, në lidhje me Komisionin e Procedimeve Disiplinore, është përditësuar rendi i ditës duke u shtuar edhe një pikë tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe ish-magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Disiplinës.

Sipas rendit të ditës, po vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite që ka të bëjë me

shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga zonja Rupa. Për më tej fjala për zonjën Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në cilësinë e relatores paraqes projektraportin e vlerësimit për gjyqtaren {...}, (gradimi), periudha e vlerësimit 2013-2016.

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares që ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë. Gjyqtarja vlerësohet në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale, me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së saj, e cila nuk mund të jetë e nivelit “Pamjaftueshëm”, pasi gjyqtarja është vlerësuar “E aftë” nga organet e rivlerësimit kalimtar. Në projektraport pasqyrohet sipas rendit kronologjik i gjithë procesi vlerësues i gradimit të gjyqtares, pasqyrohet e plotë procedura e vlerësimit, burimet e vlerësimit si dhe analiza e të dhënave që burojnë prej tyre.

Gjyqtarja është shprehur dakord me projektraportin e vlerësimit, kështu që unë do të ndalem në mënyrë të përmbledhur në analizën e nivelit të vlerësimit, pasqyrimin e nivelit të vlerësimit dhe të pikëzimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit.

Në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, “Njohuritë ligjore”, 1.A.A Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktim të cilin e bën në mënyrë të shprehur, duke e referuar si konkluzion të analizës së saj mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Rezulton gjithashtu aftësi shumë e mirë në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore, që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi. Në këto kushte, në lidhje me këtë tregues, propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Në lidhje me 1.A.b Aftësitë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe

material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuara, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të referuar, zbatuar dhe kur është rasti për të analizuar aspekte të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet brumi vlerësimi, gjyqtarja ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ. Kështu që lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Lidhur me “Arsyetimin ligjor”, gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej saj për zgjidhje, apo zgjidhjen tërësore të çështjes. Spikat konciziteti në paraqitjen e rrethanave të faktit, çka e bën natyrën e konfliktit lehtësisht të kuptueshëm për çdo lexues dhe jo vetëm për njohësit e ligjit. Lidhur me qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e vendimit propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikëzimi 15.

Për të kaluar tek 1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit gjyqësor, në tërësi, rezultojnë se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Kjo mënyrë e standardizuar e të shkruarit të vendimit gjyqësor, orienton lexuesin dhe i shërben kuptueshmërisë së logjikës juridike për atë që është konkluduar. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 10.

Gjyqtarja gjithashtu ka aftësi shumë të lartë edhe në lidhje me treguesin 1.B.c

Cilësia e analizës dhe argumentit logjik - Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Lidhur me këtë tregues “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Kështu që niveli i vlerësimit dhe i pikëzimit në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Në lidhje me “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, 2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, analizohet pikë së pari në 2.A.a. Respektimin e afateve ligjore. Nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe çështjeve të administruara për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve, nuk rezulton që për shqyrtimin e tyre, ligji të ketë parashikuar afat ligjor shqyrtimi. Kështu që do të prezumohet që gjyqtarja i ka gjykuar të gjitha çështjet për të cilat parashikohet afat ligjor. Propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë lidhur me treguesin “Respektimin e afateve ligjore”.

Lidhur me 2.A.b. Plotësimin e standardeve minimale kohore, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short dhe çështjes së referuar nga ish-Inspektorati i KLD-së për tu mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional, pa përfshirë 3 (tre) vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se për 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 1 (një) çështje të referuar për kohëzgjatjen e gjykimit, nga verifikimi i ankesave, rezulton se gjykimi ka

zgjatur më tepër se standardi minimal kohor 1 muaj, sipas vendimit nr.261/2 të KLD. Kryesisht çështjet kanë përfunduar brenda afateve nga 31 ditë pjesa më e madhe deri në 345 ditë. Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit në 11 dosjet e përzgjedhura me short është rreth 53 ditë ose 1 muaj e 23 ditë dhe në çështjen e administruar të referuar për shkak të ankesave gjykimi ka zgjatur 345 ditë ose 11 muaj e 15 ditë.

Në çështjen e referuar për vlerësim etik dhe profesional, për shkak të kohëzgjatjes së gjykimit, rezulton se çështja administrative e përfunduar me vendimin nr.228, datë 26.01.2016, gjykimi ka përfunduar për 345 ditë ose 11 muaj e 15 ditë. Në kohëzgjatjen e gjykimit të kësaj çështjeje rezulton të ketë ndikuar edhe periudha e pezullimit të gjykimit deri në përfundim të shqyrtimit nga Gjykata e Lartë të ankimit të veçantë të paraqitur nga pala e paditur lidhur me vendimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit. Konkretisht, rezulton se çështja ka qenë e pezulluar për periudhën 31.03.2015-22.09.2015, pra për 175 ditë ose 5 muaj e 25 ditë. Duke zbritur këtë periudhë në të cilën çështja ka qenë e pezulluar, atëherë kohëzgjatja e gjykimit për këtë çështje do të rezultonte 170 ditë ose 5 muaj e 20 ditë.

Në total, për 12 çështjet e analizuara, koha mesatare e përfundimit të gjykimit rezulton të jetë rreth 63 ditë ose 2 muaj e 3 ditë.

Duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve për të cilat gjykimi ka përfunduar tej standardit minimal kohor, në raport me numrin e çështjeve të analizuara, rezulton se të gjitha çështjet janë përfunduar tej këtij afati, duke e tejkaluar nga disa ditë deri në disa muaj në disa çështje.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit ose kërkesave pa palë kundërshtare, përveç parashikimeve të afatit ligjor të gjykimit për kërkesa të posaçme të tilla si: kërkesa për sigurimin e padisë, për të cilën neni 28, pika 3, e ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 5 ditor të shqyrtimit apo çështje të tjera administrative të cilat, sipas ligjeve të posaçme, duhet të shqyrtohen brenda një afati të përcaktuar.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve

procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25, të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7-ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10-ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10-ditor për depozitimimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20-ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5-ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë, zgjatin mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27, pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15-ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.Civile për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh ose rreth 3 muaj. Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit, si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues në fuqi.

Referuar afatit 87-ditor, të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen

e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton se nga 12 çështje të analizuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritje vetëm matematikore, vetëm 1 prej tyre, ose 8.3% e çështjeve, kanë përfunduar përtej këtij afati.

Kështu lidhur me këtë konkluzion propozohet niveli i vlerësimit të gjyqtares me 5 pikë.

Në lidhje me 2.A.c. Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi i mësipërm, duke konsideruar afatin 87-ditor si standard minimal kohor për efekte të krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, rezulton se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është e lartë, pasi për të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare është më e shkurtër se standardi, kështu që propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon 2.A.ç. Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore, rezulton që rendimenti për tre vitet bashkë rendimenti i përfundimit të çështjeve si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1492 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1539 çështje), është 97%. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 97%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai që përcaktohet në metodologji, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”.

Bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, rezulton se gjyqtarja (i) për vitin 2015 ka përfunduar 391 çështje me palë kundërshtare, ose rreth 160% më shumë se standardi sasiore të punës; (ii) për vitin 2016 (deri në 08.10.2016) ka përfunduar 395 çështje me palë kundërshtare, ose 237% më shumë se standardit sasiore të punës (duke u mbështetur në këto të dhëna), vlerësoj dhe propozoj që në lidhje me

treguesin rendimenti në punë gjyqtarja të pikëzohet me 10 pikë, pra të rritet me një nivel.

Për sa i takon 2.A.d. Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit:

(i) për kategorinë “Administrative me palë kundërshtare”, është 8 ditë, pra tejkalimi i afatit procedural 7- ditor është vetëm me një ditë;

(ii) për kategorinë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 6 ditë.

Në tërësi, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar vlerësoj të klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategorive të çështjeve”. Për këtë arsye propozohet niveli i pikëzimit për këtë gjyqtare me 15 pikë.

Lidhur me 2.B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore, 2.B.a. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive, nga tërësia e të dhënave, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në çështjet e vëzhguara varion nga 1 deri në 4 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 11 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 2 seanca.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, rezulton se gjyqtarja ka mbikëqyrur dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët. Konstatohet se nga ana e gjyqtarës merren të gjitha masat me qëllim shmangien e seancave joproduktive dhe numri mesatar i seancave në masën 2, vjen për shkak të respektimit të detyrimit ligjor për t’i komunikuar palës së paditur në mungesë ndryshimin e objektit të padisë apo për dhënien e kohës palëve për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare.

Nga sa relatova, propozoj që lidhur me këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet me 15 pikë.

Gjithashtu edhe në lidhje me treguesin 2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, duke iu referuar burimeve të vlerësimit,

rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në veprimet përgatitore, seancat përgatitore, dhe seancat gjyqësore të zhvilluara. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 20.

Lidhur me 2.C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore, si në aspektin e 2.C.a. Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes ashtu edhe lidhur me 2.C.b. Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, propozohet niveli i lartë, shumë i lartë i vlerësimit dhe pikëzimi maksimal, për arsye sepse në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa vështirësi. Po ashtu edhe dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacioni i cili nuk i përket çështjeve konkrete. Pra propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit për të dy këta komponentë.

Kështu që për “Aftësitë organizative të gjyqtares”, propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Për të kaluar tek “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, gjyqtarja është vlerësuar në nivelin shumë të lartë, pikët 100, për këtë kriter dhe për të gjithë treguesit propozohet gjithashtu vlerësim shumë i lartë për arsye sepse në lidhje me “Etikën në punë”, në raportin për analizimin e aftësive profesionale konkludohet se sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtares znj. {...}.

Ka gjithashtu angazhim dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion. Gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore në lidhje me gjyqtaren.

Nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojnë shfaqje dhe sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin dhe dinjitetin dhe pritshmëritë e publikut.

Nga ana tjetër gjyqtarja në asnjë rast nuk rezulton të ketë përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj.

Lidhur me numrin tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve është vlerësuar “i pakonsiderueshëm”. Dhe lidhur me këtë nëntregues gjyqtarja vlerësohet me pikët maksimale.

Kështu që propozimi për nivelin e vlerësimit në lidhje me “Etikën dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozohet të jetë niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek kriteri “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, “Aftësia e komunikimit”, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave përgatitore dhe gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Gjyqtarja rezulton gjithashtu, në aspektin e respektimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të këtyre treguesve, prandaj propozohet niveli i vlerësimit i lartë, pikëzimi 15 lidhur me këtë nënkriter.

4.B. Aftësia për të bashkëpunuar, shfaqet në nivel shumë të mirë si në aspektin e 4.B.a. Shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, ashtu edhe sa i përket 4.B.b. Shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Propozohet nivel shumë i lartë i vlerësimit për të dy këto tregues, pikëzimi 15 pikë dhe 10 pikë.

Në lidhje me 4.C. Gatishmërinë e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, rezulton se zonja {...} ka marrë pjesë në 11 aktivitete të formimit profesional të llojit trajnime dhe seminare, brenda dhe jashtë programit të formimit vazhdues, të cilat kanë zgjatur në një periudhë totale prej 15 ditëve. Pra lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera propozohet niveli i vlerësimit me 20 pikë.

Për sa i takon 4.C.b. Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, gjatë periudhës së vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë angazhim të tillë, prandaj pikëzohet në nivelin e tre pikëve.

Lidhur me treguesin 4.C.c. Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-

institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata, evidentohet që gjyqtarja të ketë marrë pjesë aktive në konferenca shkencore dhe veprimtari të tilla, prandaj propozohet niveli i vlerësimit 5 pikë edhe lidhur me këtë tregues.

Gjithashtu edhe në lidhje me 4.C.ç. Publikimet ligjore akademike, rezulton që gjyqtarja të ketë publikime të tilla në revista shkencore me ISSN (pra ka 3 botime të tilla gjatë periudhës së vlerësimit) dhe në këto kushte propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë lidhur me këtë tregues.

Kështu që në lidhje me “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 98.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi i vlerësimit për çdo kriter lidhur me gjyqtaren {...} propozohet si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, pikët 100, niveli "Shkëlqyeshëm";

Aftësitë organizative të gjyqtarit, pikët 100, niveli "Shkëlqyeshëm";

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli "Shkëlqyeshëm";

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 98, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Vlerësimi i përgjithshëm 398, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.12.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektraportit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019”, relatores znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:56 dhe mbaroi në orën 15:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Entela Dobi dhe Denisa Varfi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
6. *BIRN.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *{...}, gjyqtar.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtim i projektraportit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019”, relatore *znj. Irena Plaku*.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektraportit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019”, për të cilin është përgatitur relacioni nga relatore *znj. Plaku*. Gjithashtu, zoti {...} ka paraqitur kundërshtime dhe nga administrata jam bërë me dije që është prezent për këtë mbledhje.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari {...}.)

Ilir Rusi: Përshëndetje zoti {...}!

Në vijim të kësaj mbledhjeje plenare, fillimisht do prezantohet relacioni nga zonja *Plaku*, pastaj është fjala për ju.

Fjala për ju zonja Plaku!

Irena Plaku: Përshëndetje!

Atëherë, po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2017-2019 për gjyqtarin {...}. Kundërshtimet janë paraqitur nga ana e tij, por do të relatohen duke qenë se është prezent personalisht (nuk po relatohen nga ana ime).

Procedura e vlerësimit ka filluar ka filluar me Vendimin nr. 371, datë 13.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku jam përcaktuar unë si relatore dhe nëpunëse përgjegjëse znj. {...}. Është kryer e gjithë procedura për vlerësimin, mbledhjen e të gjitha burimeve të vlerësimit. Më pas më datë 19.10.2023 nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin është dorëzuar raporti analitik. Pasi është gjetur dosja e plotësuar, ka vijuar me hartimin e projektraportit i cili i është njoftuar gjyqtarit dhe ky i fundit ka paraqitur kundërshtime me të cilat ju jeni njohur të gjithë (duke qenë se i janë dërguar të gjithë anëtarëve në rrugë elektronike).

Shkurtimisht po relatoj gjetjet për sa i përket katër kritereve të vlerësimit.

Konkretisht tek “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, për të cilën edhe vetë gjyqtari ka paraqitur kundërshtime.

Sa i përket treguesit 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), gjyqtari përgjithësisht i përshkruan dhe analizon faktet e çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin e çështjes, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsyetimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale, në disa nga vendimet penale apo civile përshkruhen dhe po ashtu analizohen në një nënndarje që përbën pjesën hyrëse të arsyetimit, të titulluar “procedura” ose “aspekte procedurale”. Në disa vendime analiza e aspekteve procedurale bëhet në pjesën arsyetuese të vendimit pas përshkrimit të rrethanave të faktit.

Në vendimet ku janë marrë në shqyrtim rrethanat procedurale, rrethana të cilat lidhen me shqyrtimin e kërkesave të palëve apo çështjeve të ngritura kryesisht për vlerësim nga gjykata, përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqërohet me vlerësimin dhe analizën ligjore lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, duke i dhënë përgjithësisht qartësi vendimit dhe duke orientuar lidhur me elementë të tillë si: ndërgjyqësia, procedura e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve.

Përgjithësisht pas paraqitjes dhe vlerësimit në lidhje me rrethanat me karakter procedural, në vendimet ku këto rrethana përshkruhen dhe arsyetohet në pjesën e parë të vendimit, gjyqtari parashtron faktet e çështjes objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e çështjes” apo “rrethanat e çështjes/prendimet e palëve”, duke i parashtruar ato përgjithësisht në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik, dhe duke integruar në disa raste në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën. Një analizë e tillë konstatohet tek çështjet penale. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve, konstatohet se përshkrimi dhe analiza e rrethanave të çështjes bëhet kryesisht sipas përshkrimit të bërë nga organi procedues/prokurori, duke pasqyruar në disa raste edhe qëndrimin e organit të akuzës, për bazueshmërinë e kërkesës së paraqitur apo se nga provat provohet fajësia e të pandehurit. Pra nuk konstatohet që gjyqtari të ketë parashtruar vetë rrethanat e faktit.

Ndërsa në çështjet familjare, konstatohet se gjyqtari paraqet në mënyrë tepër të përmbledhur rrethanat e faktit, në nënndarjen e saj, duke përshkruar vetëm faktin që ka të bëjë me lidhjen e martesës dhe faktin se bashkëshortët kanë fëmijë, por nuk përshkruhen dhe analizohen faktet siç kanë rezultuar nga pohimet gjyqësore të palëve apo fakte të cilat lidhen me fëmijët e mitur, por këto të fundit analizohen në mënyrë tepër të përmbledhur në pjesën e vlerësimit të gjykatës.

Ndërsa në çështjet e themelit civile me palë apo pa palë kundërshtare konstatohet se gjyqtari në pjesën e parë të pjesës arsyetuese të vendimit, megjithëse në disa raste kjo pjesë titullohet “rrethanat e faktit”, “rrethanat e faktit të pretenduar nga paditësi” apo “gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se”, nuk përshkruan rrethanat e çështjes siç kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor, duke i shoqëruar me evidentimin, referimin dhe

analizën e provave të administruara në gjykim. Gjyqtari paraqet rrethanat dhe faktet, ashtu siç janë pretenduar nga pala paditëse, si dhe pretendimet e kësaj pale lidhur me mbështetjen e këtyre pretendimeve në ligj dhe në prova si dhe përshkrimin e tyre sipas prapësimeve të palës së paditur. Pra gjyqtari në këto vendime pasqyron vetëm pretendimet e palëve në mënyrë të detajuar, si në lidhje me përshkrimin e rrethanave dhe faktit ashtu dhe në lidhje me bazueshmërinë në ligj ose jo të kërkimeve të tyre, çka e bën të paqartë vendimin në këtë pjesë të tij. Më pas disa rrethana të vlerësuara të rëndësishme nga gjyqtari (të cilat nuk janë tek pjesa e parë), analizohen në pjesën “vlerësimi të gjykatës” lidhur me bazueshmërinë e tyre në ligj.

Lidhur me identifikimin e natyrës së çështjes.

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i fakteve të çështjes, gjyqtari përgjithësisht përcakton natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve. Thuajse në të gjitha vendimet civile burim vlerësimi, gjyqtari identifikon dhe përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së rrethanave procedurale dhe analizës së faktit. Në çështjet penale, natyra e çështjes rezulton e qartë nga objekti i çështjes dhe identifikohet në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, siç janë rastet e çështjeve të seancës paraprake, në të cilat objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse. Po ashtu në çështjet penale, identifikimi i natyrës së çështjes objekt shqyrtimi i shërben orientimit të arsyetimit të vendimit, duke reflektuar specifikat e çështjeve penale të themelit.

Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtari përgjithësisht përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (siç janë përmbushje detyrimi kontraktor; pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv; kthim prone; etj.

Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike jo gjithmonë është identifikuar në mënyrë specifike, por del qartë në shumicën e vendimeve referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në vendimet gjyqësor burim vlerësimi.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm.

Përcaktimi i saktë natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me

kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështje, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari përgjithësisht identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e çështjes, konstatohet se: Në vendimet civile janë përshkruar në projektraport dispozitat të cilat janë cituar referuar nga gjyqtari (për zgjidhje mosmarrëveshjes) gjithashtu janë cituar edhe dispozitat përkatëse të pjesës së posaçme penale por edhe procedurale në çështjet penale.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në vendimet civile gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës. Këtu janë cituar edhe dispozitat dhe arsyet për të cilat janë cituar nga ana e gjyqtarit.

Krahas Kodit Civil, janë përmendur edhe dispozitat e ligjit të posaçëm, konkretisht ligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, “Për shoqëritë tregtare”, ligji “Për komunikimet elektronike” (përsëritet), “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së energjisë elektrike”, ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.

Gjithashtu gjyqtari identifikon dispozitat e pjesës së posaçme dhe pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

Sa i përket konfliktit të normave në një vendim me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq dhe pushim i pjesshëm i hetimit”, gjyqtari ka një konflikt për sa i përket nenit 332 pikat 1 dhe 2 dhe nenit 332/a pika 3, sa i takon caktimit të seancës paraprake, konkretisht lidhur me afatin.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton aftësia e gjyqtarit për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre

me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, kryesisht në çështjet penale, të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës. Por edhe në këtë rast faktet dhe rrethanat përshkruhen ashtu siç janë paraqitur nga organi procedues. Ndërsa në vendimet civile rezulton se gjyqtari nuk përshkruan dhe analizon faktet e çështjet siç kanë rezultuar nga gjykimi, por ato pasqyrohen në vendim, vetëm sipas përshkrimit dhe analizës që i ka bërë secila palë fakteve të çështjes në mbështetje të pretendimeve të tyre, duke mos dhënë kështu gjithmonë një panoramë të qartë të fakteve që kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor. Ndërsa rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

Për sa më sipër, për këtë tregues është propozuar niveli i vlerësimit mesatar, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket kriterit 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përgjithësisht bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore përmenden ose citohen duke u shoqëruar përgjithësisht me interpretimin e tyre abstrakt dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Por konstatohet se në një pjesë të vendimeve, interpretimi abstrakt zë pjesën më të madhe të vendimit, ndërsa aplikimi i tij mbi faktet e çështjes, pra si ligji gjen zbatim në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes paraqitet tepër i përmbledhur dhe në disa raste mungon një arsytim i tillë (janë cituar edhe vendimet ku është konstatuar mungesë e një arsytimit të tillë), duke konkluduar direkt në përfundimet për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari, në disa

vendime burim vlerësimi, citimin ose referimin në dispozita e shoqëron me interpretimin të tyre në mënyrë të abstrakte, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Por nuk i kushton të njëjtën rëndësi arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, të cilat jo gjithmonë shoqërohen me interpretim të ligjit konkret, apo me interpretimin e normave në funksion të rrethanave të çështjes sidomos tek shqyrtimi i kërkesave penale me objekt – dërgim çështjesh në gjykim apo pushim gjykimi, apo në çështjen penale, gjykim me marrëveshje, ku gjyqtari nuk citon dhe analizon se si ligji gjen zbatim në raport me faktet konkrete si dhe aktet provuese. Një interpretim i tillë konstatohet edhe tek çështjet familjare me objekt zgjidhje martesë, ku gjyqtari tej zgjatet në interpretimin abstrakt të ligjit, apo të natyrës së marrëdhënies së posaçme të martesës dhe të pasojave të zgjidhjes së saj, e cila zë dhe pjesën më të madhe të vendimit, duke u ndalur shkurtimisht në interpretimin e ligjit në raport me rrethanat e çështjes ku në disa raste mungon një analizë e tillë, por mjaftohet vetëm me dhënien e konkluzioneve përkatëse.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm: Konkretisht në çështjet civile është konstatuar që interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete. Ndërsa analiza e normës në raport me faktin që ka rezultuar në gjykim, paraqitet tepër i përmbledhur dhe në disa raste mungon një interpretim i tillë. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari ka analizuar marrëdhënien juridike të detyrimit; analizon natyrën e vendimeve të ish-KKKP; analizon revokimin e dhurimit duke cituar edhe dispozitat përkatëse.

Gjithashtu gjyqtar interpreton në vendimet penale edhe dispozitat e pjesës së posaçme dhe të përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me cilësinë e veprës penale, elementët e saj (që përgjithësisht ndalet gjatë interpretimit të tyre për çdo vepër penale në gjykim), moshën për përgjegjësi penale, bashkëpunimin, pezullimin e dënimit. Më konkretisht janë cituar edhe dispozitat të cilat analizohen nga ana e gjyqtari.

Gjithashtu interpreton edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, merr në analizë nenin 332, 332/a K.Pr.Penale, të cilat krijojnë konflikt me njëra tjetrën.

Në çështjen civile që i përket vendimit të datës 17.10.2019, rezulton se gjatë gjykimit gjyqtari ka pranuar kërkesën e ndërhyrësit kryesor për të ndërhyrë në gjykim, me padinë duke cituar nenin 189, 190 dhe 55 të K.Pr.Civile, por pa bërë një interpretim të tyre, si një analizë të kësaj vendimmarrje të gjykatës, në lidhje me momentin procedural se kur një kërkesë e tillë paraqitet në gjykatë e pranohet nga gjykata, që sipas dispozitave të mësipërme mund të pranohet deri sa nuk është nxjerrë urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Në dosjen gjyqësore që i përket këtij vendimi, ndodhet vendimi i ndërmjetëm i gjykatës për bashkimin e çështjes, ku gjyqtari ka referuar nenin 57 të K.Pr.C., përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr.38/2017, duke mos bërë kështu referimin e saktë të ligjit të zbatueshëm në fuqi në kohën e shqyrtimit të padisë. Gjyqtari analizon rastin e bashkimit të dy çështjeve të regjistruara më vete që kanë lidhje mes tyre për nga objekti, duke referuar faktin se janë familjare, si dhe ka të bëjë me të njëjtin rast gjykimi, por pa referuar dhe arsyetuar se si gjen zbatim dhe aplikohet në rastin konkret neni 189 dhe 190 të K.Pr.C., në lidhje me nenin 57 të K.Pr.C., në kushtet kur gjyqtari ka pranuar për shqyrtim kërkesën e ndërhyrësit kryesor për të ndërhyrë në gjykim dhe më pas ka bërë edhe një vendim për bashkimin e çështjes.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, konstatohet se gjyqtari përdor jurisprudencën relevante. Janë cituar edhe vendimet e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese. Por në një vendim është konstatuar që gjyqtari ka identifikuar dhe ka përdorur si referencë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, me pavlefshmërinë e veprimeve juridike, përkatësisht vendimin nr.13, të vitit 2006 si dhe vendimin nr. 3, të vitit 2006 të cilat konstatohet se nuk janë përdorur nga gjyqtari për të mbështetur argumentimin e tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe as nuk rezultojnë se kanë lidhje me çështjes, për sa kohë që çështja ka për objekt revokimin e kontratës së dhurimit dhe jo pavlefshmërinë e saj. Gjithashtu, nuk konstatohet se gjyqtari ka arsyetuar kryesisht lidhur me pavlefshmërinë e këtij veprimi juridik.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të së drejtës, konstatohet se gjyqtari përgjithësisht citon dhe zbaton parimet e së drejtës.

Referuar sa më sipër burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira

të interpretimit të dispozitave të ligjit material dhe procedural, duke bërë kryesisht një interpretim abstrakt të normave që gjejnë zbatim në rastin konkret, dhe në disa raste duke i integruar edhe me provat e marra. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në interpretimin e ligjit në raport me provat e marra në shqyrtim si në çështjet penale dhe civile, ku në disa vendime konstatohet se mungon tërësisht interpretimi i ligjit në raport me faktet e çështjes, pra si ligji gjen zbatim mbi faktet objekt gjykimi. Vetëm referimi formal i ligjit, i pashoqëruar me një analizë të dispozitave, raportit midis tyre dhe zbatimit mbi rrethanat e faktit, sipas rastit, mund të jetë tregues i një mungese të aftësive për të interpretuar ligjin. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ si dhe ka treguar kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Por në një vendim (siç e relatuam më sipër) konstatohet se ka referuar dy vendime unifikuese të cilat nuk kanë shërbyer arsytimit të vendimit.

Sa i përket treguesit 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Në tërësi referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit. Pra është konstatuar se përgjithësisht gjyqtari zbaton rregullat e drejtshkrimit, përdor fjali me gjatësi mesatare, në disa raste me gjatësi më të gjata por nuk krijon paqartësi. Referuar sa më sipër është propozuar aftësia e gjyqtarit për këtë tregues shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit. Gjyqtari në hartimin e vendimit përgjithësisht ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikëpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale, apo të themelit të çështjes, megjithëse jo në të gjitha vendimet, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit

logjik. Megjithëse konstatohet se gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji strukturimi të pjesëve përbërëse të vendimit, duke e ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit në nënndarje, përgjithësisht të identifikuara me tituj dhe në paragrafë, duke i dhënë qartësi vendimit nga pikëpamja formale, nuk konstatohet e njëjta metodologji strukturimi tek secili vendim, ku pjesë të ndryshme të pjesës arsyetuese – përshkruese, të identifikuar me tituj, pasqyrohen në vende të ndryshme të vendimit, cilat jo gjithmonë vijnë në rrjedhë logjike midis tyre. Gjithashtu, konstatohet se në disa vendime edhe pse ka një pjesë të titulluar që referon rrethanat dhe faktet, përmbajtja e kësaj pjesë nuk e reflekton atë, pasi në to mungon pasqyrimi i rrethanave të faktit siç ka rezultuar nga gjykimi.

Në pjesën e parë hyrëse përgjithësisht gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, sekretaria gjyqësore, data e regjistrimit, baza ligjore si dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Gjithashtu në dy vendime janë caktuar edhe analiza e çështjeve të juridiksionit të kompetencës.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa nënpjesë, të cilat përgjithësisht janë të identifikuara me tituj, duke orientuar lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Por konstatohet se mënyra e organizimit të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin nuk ndjek gjithmonë të njëjtën renditje. Gjithashtu, në disa raste konstatohet se përmbajtja e nënpjesës së vendimit jo gjithmonë ka lidhje me titullin e vendosur në këtë pjesë. Megjithatë konstatohet se pjesa arsyetuese është ndarë si më poshtë: procedura, rrethanat e faktit, vlerësimi i gjykatës lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe referimit të ligjit të zbatueshëm, arsyetimi vijon me nënndarjen “Vlerësimi i gjykatës”, në të cilin, sipas kategorisë së vendimeve gjyqtari zhvillon analizën ligjore të çështjes. Është bërë edhe këtu një analizë e zgjeruar.

Në lidhje me dispozitivin gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi: (i) çdo kërkim të objektit të padisë (pranimin apo rrëzimin), (ii) përgjegjësinë penale të autorëve, (iii) dënimin e masës (iv) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit, etj. Disponimi lidhur me shpenzimet gjyqësore përgjithësisht është i qartë dhe i plotë, pasi në pjesën më

të madhe të vendimeve bëhet pasqyrimi i shpenzimeve gjyqësore, dhe përcaktimi i saktë i raportit të pjesës...

Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit, gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj. Në një vendim civil rezulton se gjyqtari nuk ka disponuar lidhur me ekzekutimin e vendimit në përputhje me nenin 310 të K.Pr.Civile, të ndryshuar me ligjin nr.38/2017, ku parashikohet se: Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre dhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga përbaruesi gjyqësor, sipas të cilës gjykata duhet të përcaktojë se vendimi është i ekzekutueshëm nga shërbimi përbarimor dhe se vendimi përbën titull ekzekutiv, sipas parashikimit të nenit 511 të K.Pr.Civile. Ndërsa në disa vendime civile dhe familjare rezulton se gjyqtari ka disponuar me lëshimin e urdhrit të ekzekutimit më vete, kur dispozitat e K.Pr.C., të ndryshuara kanë parashikuar se gjyqtari duhet të shprehet se vendimi përbën titull ekzekutiv, siç citohet shprehimisht në nenin 310.

Siç e theksuam më lart, gjyqtari megjithëse nga pikëpamja formale duket se ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, nga përmbajtja e tyre nuk konstatohet një gjë e tillë. Secili vendim, ka një strukturë të caktuar, që ndryshon nga tipet e ndryshme të vendimeve, dhe ndonjëherë fjalitë hyrëse përshkruese të vendosura si titull nuk pasqyrojnë përmbajtjen. Megjithatë titujt nuk janë me ndarje. Janë paragrafët, të cilët gjyqtari i përdor rregullisht, në njësi më të thjeshta. Por nga përmbajtja e paragrafëve në disa vendime, konstatohet se jo gjithmonë ato janë renditur në atë mënyrë që mendimi të vijë rrjedhshëm, njëri pas tjetrit.

Në tërësi, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është vlerësuar mbi mesatare. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata; parashtrimi i rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura. Në disa raste konstatohet që nëndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të

qartësisë dhe kuptueshmërisë duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar. Por konstatohet se jo gjithmonë fjalitë tematike të përdorua pasqyrojnë përmbajtjen e saktë. Kështu në disa vendime, megjithëse ka një nënpjesë që identifikon rrethanat e çështjes, në atë pjesë mungon pasqyrimi i tyre. Gjithashtu, edhe pjesa e fundit jo gjithmonë është e qartë në lidhje me disponimin mbi faktin nëse vendimi përbën titull ekzekutiv dhe kur lëshohet urdhër. Sa më sipër, për këtë tregues propozohet pikëzimi i tij mbi mesatare, pikëzimi me 8 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik. Në vendimet e analizuara, përgjithësisht rezulton një nivel i mirë arsytimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar elementët e nevojshëm të vlerësuar nga gjyqtari në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; përcaktimit të barrës së provës dhe rolin e gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, të cilat siç e theksuam në raport jo gjithmonë paraqiten në mënyrë të saktë, të plotë dhe koncize, zhvillohet mbi bazën e një analize juridike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore dhe të përmbledhur të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të fakteve të vlerësuar si të provuara në gjykim. Në disa vendime burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore përpara aplikimit mbi faktet konkrete, e cila zë pjesën më të madhe të vendimit, në raport me analizën e këtyre koncepteve në raport me faktet e çështjes.

Në projektraport janë cituar edhe analiza e bërë nga ana e gjyqtarit për disa koncepte dhe institute si në disa vendime civile ashtu edhe në vendimet penale. Në vendimet penale gjyqtari paraqet dhe analizon faktet të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim, sipas përshkrimit të bërë nga organi i prokurorisë, e cila zë pjesën më të madhe arsytimit të vendimit dhe merr në analizë elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolin dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar shpeshherë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me provat, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të

provueshmërisë.

Gjyqtari integron faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve. Por konstatohet se argumenti logjik përgjithësisht dominohet nga analiza abstrakte e koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale, në raport me zbërthimin dhe analizën e këtyre koncepteve në lidhje me faktet e çështjes dhe aktet provuese mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit, të cilat përgjithësisht vetëm përshkruhen siç kanë rezultuar pa u bërë një analizë individuale nga gjyqtari.

Gjyqtari përgjithësisht ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit, faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, edhe pse kjo paraqitet tepër e përmbledhur në disa raste, i shërben arsyetimit ligjor.

Konstatohet se gjyqtari i kushton rëndësi analizës së koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes, e cila zë dhe pjesën më të madhe të vendimit, duke bërë një analizë për qëllimin dhe funksionin përkatës të dispozitave, si dhe të zbërthimit të kushteve apo elementëve të nevojshëm me qëllim që dispozita përkatëse të gjejnë zbatim. Por nuk konstatohet e njëjta shkallë kujdesi tek vendimet, vendimet civile, familjare apo dhe kërkesat penale, në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore dhe argumentit logjik, në raport me faktet e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhënies shkak-pasojë, e cila në disa raste paraqitet tepër skematike dhe në disa raste argumenti mungon, duke konkluduar direkt në konkluzionet e gjyqtarit lidhur me provueshmërinë dhe bazueshmërinë në ligj e në prova të kërkimeve të paraqitura. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, analiza përqendrohet kryesisht në interpretimin abstrakt të dispozitave, e cila dominon pjesën e vlerësimit të gjykatës, duke e shoqëruar edhe me praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë, apo dhe të qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa analiza ligjore në raport me faktet e provuara, pra argumenti logjik në raport me faktet e provuara paraqitet në mënyrë

të përmbledhur, duke mos integruar gjithmonë si pjesë të saj edhe provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit. Analiza e koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, është shumë e rëndësishme, por nuk është e mjaftueshme në rast se kjo analizë nuk shoqërohet edhe më një analizën të detajuar të provave të marrë në shqyrtim, e cila gjithashtu është një pjesë shumë e rëndësishme e arsytimit të vendimit gjyqësor në tërësi. Gjyqtari nuk duhet të jetë thjesht përshkruar i rrethanave apo i provave siç ka rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor e aq më pak me përshkrimin e tyre sipas pretendimeve të palëve, por duhet të analizojë provat në raport me njëra tjetrën, duke e gërshetuar arsyetimin në raport ligjin që gjen zbatim. Përgjithësisht konstatohet rrjedha logjike në arsyetimin e vendimit dhe cilësia analitike e vendimit është në një nivel mesatare, pasi nuk spikat analiza juridike e koncepteve dhe e dispozitave ligjore në raport me rrethanat konkrete të çështjes, e cila lidhet drejtpërdrejte me konkluzionet e arritura.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve. Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse. Por jo gjithmonë gjyqtari identifikon qartë dhe në mënyrë të plotë pretendimet e palëve, duke i paraqitur ato të ndara, por ata dalin si rezultat i analizës juridike. Në çështjet më komplekse, gjyqtari është kujdesur të pasqyrojë dhe marrë në analizë pretendimet e palëve ndërgjyqëse (duke krijuar edhe paragrafë me fjali hyrëse në lidhje me këto pretendime), si në raport me arsyetimin e koncepteve ligjore dhe zbërthimin e këtyre koncepteve në raport me rrethanat e provuara dhe provat ku palët bazojnë pretendimet e tyre. Por edhe në këtë drejtim nuk konstatohet i njëjti kujdes i gjyqtarit, sidomos në analizën e pretendimeve të palëve në raport me ligjin, duke i integruar me faktet e çështjes. Kështu në vendimin e datës 17.10.2019, mungon analiza e të gjitha kërkimeve të palës paditëse të pasqyruar në objektin e kërkesë padisë, të cilat janë pranuar në tërësi nga gjykata. Ndërsa në një vendim të vitit 2018, gjyqtari nuk i ka dhënë një përgjigje të argumentuar për kërkimin e parashtruar në padi, lidhur me faktin nëse sendi ka qenë i lirë në kuptim të ligjit dhe a mundet ai t'i kthehet ose kompensohet fizikisht pronarit sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.

Referuar sa më sipër, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, vlerësuar në tërësinë e tyre dhe në raport me natyrën çështjes, rezulton se gjyqtari ka aftësi mesatare lidhur me këtë tregues. Në disa vendime burim vlerësimi, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe mbështetet në disa raste në qëndrimet e praktikës gjyqësore. Megjithatë duke i vlerësuar vendimet burim vlerësimi në tërësi nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentit logjik si dhe në lidhje me çështjet e procedurës ashtu edhe të themelit pasi në një pjesë të vendimeve mungon komponenti i analizës juridike të ligjit të zbatueshëm, në disa vendime megjithëse është bërë një analizë e koncepteve të së drejtës apo ligjit të zbatueshëm, mungon ndërthurja e këtyre koncepteve me interpretimin e ligjit të zbatueshëm në raport me mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet e çështjes. Gjithashtu edhe pse konstatohet se disa vendime janë gjithëpërfshirëse në raport me kërkesat e palëve të cilat marrin përgjigje të argumentuar, kjo e fundit jo gjithmonë bazohet në një vlerësim të pavarur të pretendimeve të ngritura bazuar në ligjin përkatës që gjen zbatim dhe faktet konkrete të çështjes, duke dalë direkt në konkluzionin për bazueshmërinë ose jo të kërimit përkatës në çështjet civile dhe penale. Ndërsa në disa vendime, gjyqtari nuk i ka marrë në analizë pretendimet e palëve në raport me bazueshmërinë e tyre në ligj apo në raport me faktet e çështjes, megjithëse për ato gjyqtari ka disponuar përfundimisht.

Referuar sa më sipër për këtë tregues vlerësohet se aftësia e gjyqtarit është mesatare dhe për këtë arsye propozohet pikëzimi me 15 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e parë është 73 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit "Aftësia organizative e gjyqtarit", për këtë tregues gjyqtari nuk ka paraqitur kundërshtime. Konkretisht po ndalem shkurtimisht tek 2.A.a Respektimi i afateve ligjore. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (deri në 2 ditë) si dhe zbritet koha gjatë se cilës ka kryer lejen vjetore, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 118 çështje dhe për pasojë, raporti i

çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit, me numrin total të çështjeve (552 çështje), rezulton të jetë 21.37%, përqindje që sipas Metodologjisë pikëzohet me 9 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, duke e tejkaluar këtë afat me 1.37 %, përqindjen prej 11-20%, që i korrespondon pikëzimit me 12 pikë; (ii) ngarkesën e gjyqtarit si relator (në total për tre vite ka gjykuar 2017 çështje, nga të cilat 27.4 % apo 552 çështje janë me afat ligjore), duke gjykuar mesatarisht rreth 669 çështje në vit, është propozuar pikëzimi i tij në nivelin e lartë, duke e rritur pikëzimin deri në 15 pikë.

Sa i përket 2.A.b Plotësimit të standardeve minimale. Referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik rezulton se nga 1465 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, që rezultojnë me afat minimal, 347 apo 23.6 % janë gjykuar jashtë standardit minimal. Është bërë përsëri një analizë e të dhënave statistikore, duke zbritur afatet të cilat nuk janë varur nga gjyqtari, ka rezultuar se pas një llogaritjeje numri i çështjeve ka zbritur në 18.8% që sipas metodologjisë pikëzohet me 4 pikë. Pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarit është vlerësuar që edhe për këtë tregues gjyqtari të pikëzohet me një nivel më të lartë, duke arritur nivelin maksimal prej 5 pikësh.

Sa i përket 2.A.c Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje. Ka rezultuar që në shumicën e kategorive duke iu referuar shumicës së kategorive 7 nga 10 kategori, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, llogaritje e cila sipas metodologjisë së pikëzohet me 4 pikë. Por duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve përgjatë periudhës 3-vjeçare, rezulton pikëzimi i tij me një nivel më të lartë duke arritur në pikëzimin maksimal prej 5 pikësh.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve, ka rezultuar që është 99%, për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 5 pikë, ashtu siç referojnë të dhënat statistikore.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit nga nëntë nënkategoritë e kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, vetëm në 3 prej tyre, koha mesatare e ka tejkaluar afatin procedural. Nga të dhënat statistikore, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është tejkaluar në

nënkategoritë e çështjeve me objekt “caktim mase”, me 1 ditë, dhe duke tejkaluar edhe në “shuarje mase”, me 0.5 ditë që është konsideruar e papërfillshme. Për sa më sipër, pasur parasysh edhe ngarkesën e gjyqtarit, është propozuar vlerësimi për këtë tregues. Koha mesatare është “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural” dhe për këtë arsye gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale, me 15 pikë.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore – edhe për këtë tregues, bazuar në sa parashtrohet për sa i përket numrit të seancave, ka rezultuar për të gjitha kategoritë e çështjeve 2.5 seanca, konkretisht për “penale themeli” ka dalë 2 seanca; për “familjare me palë kundërshtare”, 3 seanca; dhe “civile me palë kundërshtare”, 2.6 seanca. Gjithashtu ka rezultuar se gjyqtari ka kryer me efektivitet dhe ka caktuar në kohë seancat. Për sa më sipër për këtë tregues është propozuar aftësia e tij shumë e lartë dhe është propozuar niveli me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale- Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për kryerjen e veprimeve paraprahe, pasi rezulton se pala e paditur është njoftuar rregullisht për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes, duke i lënë edhe një afat 30-ditor për caktimin e seancës përgatitore dhe gjyqësore pas caktimit të çështjes. Në të gjitha çështje civile, me palë kundërshtare, pasi kryerjes së veprimeve paraprahe gjykata është shprehur me vendim për caktimin e seancës përgatitore, e cila përmban urdhërimin e sekretarisë për planifikimin dhe urdhërimin e njoftimit të palëve për këtë datë, por pa e arsyetuar vendimin pse është i nevojshëm caktimi i seancës përgatitore sipas kriterëve të parashikuara në nenin 158/b K.Pr.Civile. Kodi i Procedurës Civile, ka parashikuar rastet kur caktohet seanca përgatitore.

Ndërsa tek çështjet me objekt zgjidhje martesë, gjyqtari ka disponuar me vendim për caktimin e seancës së pajtimit, duke urdhëruar planifikimin e seancës si dhe urdhërimin e njoftimit të palëve. Pas zhvillimit të seancës së pajtimit, gjyqtari ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, pra pa caktuar dhe zhvilluar seancë përgatitore sipas nenit 158/b, të ndryshuar, megjithëse nga ana e gjykatës është vlerësuar e nevojshme marrja e provës me ekspert, i cili më pas është caktuar në seancë gjyqësore. Pas zhvillimit të seancës së pajtimit, gjykata në një vendim ka

disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke zhvilluar direkt seancën gjyqësore, megjithëse pala e paditur ka qenë në mungesë dhe nuk është njoftuar për vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore e cila është detyrim sipas dispozitave të K.Pr.Civile, të ndryshuar.

Në çështjet civile themeli, gjyqtari pas zhvillimit të seancës përgatitore, ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, urdhër i cili në disa raste është i formalizuar (me shkrim) e në disa raste mungon, e për pasojë edhe urdhërimi i gjyqtarit për njoftimin e tij palëve ndërgjyqëse sipas nenit 158/c, sidomos kur palët kanë qenë në mungesë.

Tek çështja civile, që i përket vendimit të datës 24.09.2019 (e regjistruar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr.38/2017), gjyqtari pasi ka kryer veprimet paraprake (konkretisht njoftimin e kërkesë padisë dhe akteve, duke e njohur edhe me të drejtën për të paraqitur deklaratë mbrojtje), ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë përgatitore e më pas në seancë gjyqësore, duke nxjerrë vendimet përkatëse, por nuk janë arsyetuar mbi shkaqet që kanë çuar në caktimi i seancës përgatitore dhe më pas zhvillimi i seancës gjyqësore, kur kjo çështje sipas parashikimeve të nenit 162 mund të zhvillohet me gjykim të shkurtuar.

Gjithashtu janë analizuar edhe disa çështje për sa i përket problematikës së konstatuar në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë aftësie mesatare në këtë tregues, evidentuar përgjithësisht në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit të seancave përgatitore apo gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat procedurale. Nuk konstatohet i njëjti kujdes nga gjyqtari në raport me kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve procedurale sipas rregullave procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (pas ndryshimeve), që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, argumentimin e vendimit për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, kryerja e seancave përgatitore efektive (pasi përgjithësisht këto seanca kanë qenë formale), caktimin e ekspertit psikolog në seancë gjyqësore, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 158/b, me

kalimin e çështjes me seancë gjyqësore si dhe me kryerjen e veprimeve procedurale pas nxjerrjes së urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, kur kodi parashikon se vendime të tilla dhe bashkimi i çështjeve apo shtimi i ndërgjyqësisë mund të bëhet vetëm në seancë përgatitore dhe jo në seancë gjyqësore siç janë bërë nga ana e gjyqtarit.

Për sa më sipër është propozuar aftësia e tij mbi mesatare duke e pikëzuar me 12 pikë.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit. Për sa i përket këtij treguesi ka rezultuar se renditja e dosjeve ka qenë e rregullt dhe e njëjtë duke ndjekur rendin logjik dhe kronologjik. Aftësia e tij është shumë e lartë duke e pikëzuar me 5 pikë.

Sa i përket 2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit, edhe për këtë tregues ka rezultuar se aftësia e gjyqtarit është shumë e lartë pasi aktet në dosje janë të plota dhe nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes përkatëse. Për këtë arsye është propozuar aftësia e tij shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësia organizative” është 92 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, konkretisht nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të cenojnë këtë tregues. Për sa më sipër është vlerësuar për këtë kriter aftësia e tij shumë e lartë dhe pikët për të gjithë treguesit është 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket kriterit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, “Aftësia e komunikimit”, 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent. Është propozuar pikëzimi i tij me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit. Ka rezultuar se gjyqtari ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të lartë. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar” si me kolegët ashtu edhe me administratën, aftësia e tij është vlerësuar maksimalisht, konkretisht 15 dhe 10 pikë.

4.C.a Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, konkretisht në programet e formimit fillestar, rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit ka marrë pjesë në 14 aktivitete të zhvilluara në 19 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në

120 ditë. Për sa më sipër propozohet pikëzimi i tij me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional. Nuk rezultojnë të dhëna lidhur me angazhimin e tij lehtësues apo ekspert. Për sa më sipër është propozuar pikëzimi i tij me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale, edhe për këtë tregues nuk rezulton angazhimi i gjyqtarit. Për këtë arsye është propozuar niveli i vlerësimit/pikëzimit me 3 pikë.

Sa i përket 4.C.ç Publikimet ligjore, gjyqtari ka pretenduar se ka disa publikime, të cilat janë të vitit 2013 dhe 2015. Në fakt i vitit 2015 është vlerësuar nga ana e Këshillit në vlerësimin e mëparshëm. Duke qenë se nuk i përkasin periudhës së vlerësimit, propozohet pikëzimi me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit sa i përket kriterit "Aftësia personale dhe angazhimi profesional" është 91 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi i vlerësimit për çdo kriter është si më poshtë:

Aftësia profesionale e gjyqtarit, pikët 73 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë";

Aftësia organizative, 92 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Aftësia personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Vlerësimi i përgjithshëm i vlerësimit është pikëzimi 356 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Për më tej fjalën zoti {...}. Do kërkoja që të ndaleshit, pasi ju keni parashtruar kundërshtime, të ndaleshit tek rubrikat për të cilat ju keni kundërshtime në mënyrë sintetike.

{...}: Faleminderit, zoti Zëvendëskryetar!

Faleminderit, të nderuar anëtarë!

Unë kam kundërshtime vetëm për atë kriterin e “Aftësive profesionale” dhe doja të ndalesha në disa pika të shkurtra, që nuk do t’ju marrë shumë kohë, fillimisht tek kampioni i dosjeve të cilat lidheshin me objekt “zgjidhje martesë”, “miratim marrëveshjeje” apo “njohje dhe kthim shume” ku interpretimi i ligjit nuk është bërë po themi... është bërë në mënyrë abstrakte në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete. Tek vendimi i bashkimit të çështjes në raport me vendimin e ndërhyrjes kryesore ku paraqet një ndërhyrje kryesore në gjykim dhe gjykata mori një vendim procedural për shkak se kishte kaluar momenti dhe ishte bashkimi konform nenit 57 të K.Pr.Civile dhe është arsyetuar më vete me një vendim të ndërmjetëm që lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Në raport me vendimet unifikuuese të Gjykatës së Lartë janë ato nr. 13/2006 dhe nr. 3/2006, të dyja këto vendime nuk janë analizuar, janë përmendur në funksion të analizimit të së drejtës si në raport me padinë, me objektin e padisë, por edhe me ndërhyrjen kryesore e cila u bashkua gjatë gjykimit dhe konkretisht tek “rregullimi i pasojave” të bëhej fshirja nga regjistri i pasurive apo të ktheheshin në gjendjen fillestare pronat objekt gjykimi sipas certifikatave fillestare.

Tek vendimet që nuk është lëshuar urdhri i ekzekutimit, ai ishte me objekt “zgjidhje martesë”, ato janë vendime të cilat ishin për shkak të ndryshimeve ligjore dhe nuk kanë shkaktuar pasoja për palët.

Tek pjesa e analizimit dhe cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik, rregullimi i pasojave është arsyetuar në fund të vendimit, është thënë “prona është e lirë” dhe është arsyetuar në të kundërt referuar barrës së provës vetëm akti i ekspertimit “nuk provon që prona është e lirë” dhe u rrëzua kërkesë padia.

Çmuj të theksoj se në raport me kundërshtimet unë kam vetëm kundërshtim në lidhje me këtë kriter dhe dua të vlerësohem në raport, të merret parasysh nga Këshilli edhe vlerësimet për të tria kriteret, që të jenë në unifikim të gjitha njëlloj sepse shkojnë bashkë, edhe për shkak të ngarkesës edhe të delegimeve të shumta apo edhe lapsuseve që mund të ndodhin në punë.

Ju falenderoj! Kaq kisha.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ka ndonjë pyetje apo diskutim?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka pyetje ndaj zotit {...}, ftoj atë të largohet me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutimet përkatëse.

Faleminderit për prezencën!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim ftoj anëtarët nëse kanë diskutime apo jo. Nëse relatorja ka diçka për të thënë pas parashtrësive të bëra nga z. {...} apo nëse ka diskutime nga anëtarët e tjerë.

Irena Plaku: Vetëm për të saktësuar disa gjëra për sa i përket ngarkesës së gjyqtarit, të cilën në fakt e kishte paraqitur edhe tek kundërshtimet - nuk e relatoi këtu - pretendon se ka qenë i deleguar në shumë gjykata. Në fakt kjo e dhënë është marrë parasysh tek të dhënat statistikore për të cilën gjyqtarit i janë rritur edhe disa nivele vlerësimi. Por gjithsesi, nga verifikimi i të dhënave statistikore rezulton se ai është caktuar në gjykata të tjera vetëm në vitin 2017-2018 dhe jo në vitin 2019, në 11 gjykime, të cilat nuk kanë qenë kërkesa me afat ligjor, të paktën sipas objektit të përcaktuar, por kanë qenë civile themeli dhe penale themeli, vetëm dy kërkesa janë gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale. Thjesht për të saktësuar.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime apo propozime nga anëtarët?

Po, zonja Shehu fjala për ju!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Unë përgjithësisht jam dakord me raportin e paraqitur nga relatorja. Kisha vetëm një vlerësim ndryshe në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, konkretisht tek

treguesi “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, duke iu referuar edhe vendimeve gjyqësore, pjesë e vlerësimit, unë do të propozoja nga 15 pikë që është vlerësuar nga relatorja, në 20 pikë.

Gjithashtu propozoj që tek treguesi “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik” propozoj vlerësimin me 25 pikë dhe jo me 15 sa është propozuar nga relatorja.

Gjithsesi ky është mendimi dhe vlerësimi im.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Po, zonja Plaku, fjala për ju!

Irena Plaku: Atëherë, shkurtimisht. Tek kriteri i parë, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është ulur në këtë nivel vetëm për sa i përket aftësisë për të parashtruar rrethanat dhe faktet. Nga të gjitha vendimet burim vlerësimi, konkretisht tek çështjet civile mungon tërësisht parashtrimi i rrethanave dhe fakteve, por janë parashtruar vetëm pretendimet e palëve megjithëse ka titullin “rrethanat e faktit”, ndërsa tek çështjet penale janë parashtruar sipas pretendimeve të prokurorit, është paraqitur në fakt kërkesa e prokurorit, aq sa gjyqtari ka harruar dhe ka shkruar në të gjitha vendimet penale që të gjitha këto fakte provojnë akuzën ndaj të pandehurit.

Nuk janë ulur për sa i përket “Aftësisë për të interpretuar natyrën e çështjes apo ligjin e zbatueshëm” se për këtë kriter është vlerësuar... prandaj është vlerësuar 15 pikë.

Sa i përket “Cilësisë dhe analizës së argumentit logjik”, siç e kam relatuar në projektraport, rezulton një nivel mesatar, pasi gjyqtari citon dispozitat ligjore por nuk i arsyeton ato në raport me rrethanat e faktit. Në disa raste bën një interpretim abstrakt të ligjit por nuk e bën atë në raport me rrethanat e faktit. Në disa raste mungon tërësisht analiza logjike e vendimit. Për sa i përket analizës është marrë parasysh, që është ulur në këtë nivel, edhe për sa i përket se nuk janë marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet e palëve, për të cilën më pas gjyqtari ka disponuar me vendim, duke iu referuar edhe vendimeve përkatëse të cilat nuk u mohuan nga ana e gjyqtarit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime të tjera?

Po zonja Luli, fjala për ju!

Fatmira Luli: Edhe unë mbështes propozimin e Marçelës.

Nisur nga interpretimi që ka bërë vetë relatorja, të problematikave që ka, nuk më duket që ai vlerësim i referon përshkrimi që ka bërë dhe gjykoj që për aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes duhet vlerësimi mbi mesatar (është vlerësuar me 15) dhe duhet vlerësuar mbi mesatar me 20 pikë.

Po kështu, në aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes duhet vlerësuar nga 20 në 25 pikë.

Në strukturën e qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, nga 8 në 10 pikë. Këto janë propozimet e mia.

Ilir Rusi: Po zonja Plaku!

Irena Plaku: Sa u referua nga anëtarja Luli, që relatoi që këto të dhëna nuk janë pasqyruar në raportin analitik, në fakt në projektraportin e vlerësimit janë pasqyruar të gjitha problematikat e hasura në secilin prej vendimeve gjyqësore të konstatuara dhe nuk tregon në fakt që unë e kam vlerësuar "Shkëlqyeshëm" se nuk kam konstatuar problematika. Unë nuk e kam vlerësuar të tillë pasi kam evidentuar të gjitha vendimet ku janë konstatuar problematikat përkatëse si lidhur me interpretimin e ligjit, me pasqyrimin e rrethanave të faktit (së pari) të cilat nuk pasqyrohen, me interpretimin e ligjit që citohet dhe për këtë arsye është vendosur 15 pikë, por nuk arsyetohen si në mënyrë abstrakte, ashtu edhe me rrethanat e faktit, ashtu edhe për sa i përket strukturës ku kishte mungesa tek pjesa e paraqitjes së rrethanave të fakteve por edhe tek dispozitivi, të cilën në fakt e ka pranuar, por arsyeton faktin se kanë qenë ndryshimet e fundit dhe nuk i ka kuptuar. Nuk mund të vlerësojmë një gjyqtar për sa kohë që është një ligj i zbatueshëm, duhet ta referojë, duhet ta zbatojë pikërisht atë ligj, i cili është i zbatueshëm në kohën që shqyrton padinë.

Edhe sa i përket analizës logjike është arsyetuar dhe janë gjetur të gjitha problematikat dhe janë pasqyruar gjerë e gjerë në raport.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, kemi propozime të bëra nga zonja Shehu dhe zonja Luli. Po i marrim me radhë, një propozim i tyre është i përbashkët, dhe pastaj vazhdojmë me perifrazimin e propozimeve, do vazhdojmë dhe me votimin.

Në lidhje me rubrikën “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”.

Për shkak të ndërprerjes së fjalëve nga propozueset, me qëllim të bëjnë rakordimet e propozimeve të tyre, atëherë vazhdojmë me votimin e propozimeve. Fillimisht është propozimi në lidhje me “Aftësitë profesionale”, konkretisht rubrika “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, propozim i përbashkët i zonjës Shehu dhe zonjës Luli, për një vlerësim nga 15 në 20, pra duke shtuar 5 pikë. Vazhdojmë me votimin.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Ilir Rusi: Dakord.

(Miratohet me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e dytë që ka të bëjë me rubrikën “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, konkretisht “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjeve”, është një propozim nga zonja Luli, për një vlerësim nga 20 pikë në 25, duke i

shtuar 5 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë tek propozimi i tretë që ka të bëjë me rubrikën “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, konkretisht “Struktura e qëndrueshëm dhe e mirëorganizuar e vendimit”, propozohet nga zonja Luli një vlerësim me 10 pikë, duke u shtuar 2 pikë në referencë të vlerësimit të bërë me 8 pikë nga relatorja.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e katërt në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, konkretisht rubrika “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, propozohet nga zonja Shehu një vlerësim nga 15 në 25 pikë, duke i rritur 10 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Ilir Rusi: Dakord.

(Miratohet me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Në vijim të shqyrtimit të këtij projektraporti, duke marrë në konsideratë edhe votimet në lidhje me propozimet dhe miratimet apo mosmiratimet e tyre, po hedhim në votim në tërësi këtë raport.

Irena Plaku: Kundër pjesërisht për sa i përket analizës, megjithëse nuk ka ndryshuar niveli i vlerësimit, unë mendoj se duhet të jemi kundër për sa i përket “Cilësisë së analizës juridike”. Nuk mund të shkojë në 25 pikë. Faleminderit!

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord, me rezervat, me votimin që kam bërë pjesërisht kundër për pikat që propozova.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për

periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.12.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi pagesën e trajtimit financiar të magjistratëve, profili gjyqtarë, të diplomuar në vitin akademik 2022 – 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:56 dhe mbaroi në orën 15:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Alban Toro | (anëtar) |
| 6. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj.***

Naureda Llagami, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes zonja *Irena Plaku* e cila u larguar pas trajtimit të çështjes së tretë të rendit të ditës.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Entela Dobi dhe Denisa Varfi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *BIRN.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi pagesën e trajtimit financiar të magistratëve, profili gjyqtarë, të diplomuar në vitin akademik 2022 – 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi pagesën e trajtimit financiar të magistratëve, profili gjyqtarë, të diplomuar në vitin akademik 2022 – 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Atëherë faleminderit!

I nderuar zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijëni, në vitin akademik 2022-2023, kanë përfunduar studimet e larta dhe janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës 40 magjistratë (profili gjyqtarë), të cilët pas përfundimit të procedurave të verifikimit, me vendimmarrje të KLGJ-së, u emëruan gjyqtarë dhe më pas u caktuan në pozicion, për ushtrimin e funksionit të magjistratit (gjyqtar) në disa gjykata.

Aktualisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë depozituar 7 kërkesë padi nga 26 të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor të trajtojë financiarisht secilin prej paditësve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, në profilin gjyqtar, në formën e pagesës, në vlerën e pagës bruto fillestare të magjistratit, për periudhën 01.07.2023 deri në momentin e caktimit në pozicion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

Paditësit si më sipër pretendojnë se referuar kuadrit ligjor në fuqi KLGJ duhet të vijonte trajtimin financiar të tyre në mënyrë të pandërprerë që prej datës 1 korrik 2023, moment në të cilin Shkolla e Magjistraturës ka ndërprerë trajtimin financiar të kandidatëve me bursën e studimit. Si rrjedhojë, ata pretendojnë që nëpërmjet pranimit të padisë, gjykata të detyrojë KLGJ të trajtojë financiarisht kandidatët për gjyqtarë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën nga 1 korrik 2023 deri në momentin e caktimit në detyrë nga KLGJ, duke i paguar me pagën bruto fillestare të magjistratit të gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me këtë çështje gjyqësore, evidentojmë faktin se tashmë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimmarrjet e saj ka krijuar një praktikë të konsoliduar sa i përket njohjes së të drejtës së kandidatëve për magjistratë të diplomuar për t’u trajtuar financiarisht nga organet e emërtesës (KLGJ dhe KLP), pa ndërprerje, nga diplomimi deri në momentin e caktimit të tyre në detyrë.

Në këto kushte, vlerësojmë se duhet marrë në konsideratë dhe si më poshtë vijon:

(i) praktikën gjyqësore të deritanishme të gjykatës që në çdo rast ka vendosur detyrimin e KLGJ-së që të trajtojë financiarisht të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës, kandidatët gjyqtarë në formën e pagesës mujore ekuivalente me pagën

bruto fillestare të magjistratit, për periudhën nga data e diplomimit deri në ditën e emërimit në pozicion;

(ii) për efekt të ekonomisë gjyqësore, me qëllim shmangien e proceseve gjyqësore të ngjashme të cilat sjellin shpenzimet të konsiderueshme të buxhetit të KLGJ-së (përmendim këtu ngarkimin me shpenzime gjyqësore, shpenzimet përmbartimore, si edhe konsumimin e burimeve njerëzore të KLGJ-së si dhe në rastet ku ka vendosur interesin që vendos gjykata);

(iii) si dhe faktin që KLGJ, ka miratuar transferim të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2023, ku ndër të tjera është parashikuar edhe trajtimi financiar i këtyre magjistratëve të rinj, shpërndarja e të cilave u bë në tetor.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e pagesës së trajtimit financiar të magjistratëve (profili gjyqtarë), të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, nga data e diplomimit deri në datën e caktimit në pozicion.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pritje të mundshme.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Në vijim të kësaj mbledhjeje theksoj faktin që zonja Plaku u largua nga kjo mbledhje për shkak të një angazhimi institucional.

Po, zonja Ukperaj, fjala për ju!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Zoti Haxhiu, kam një pyetje.

Në relacionin dhe në përgatitjen e projekt-aktit me disponimin (por do ta them pastaj edhe si e shikoj unë teknikën legjislative të të shkruarit), ku jeni bazuar, në vendimet gjyqësore që janë dhënë para ndryshimeve të ligjit “Për statusin” apo pas? Dua të theksoj diçka.

Para vitit 2021 nuk ka qenë i parashikuar në ligjin e statusit afati njëmuor të cilin

Këshilli e ka në dispozicion për të bërë kualifikimin dhe emërimin e të diplomuarve. Në vitin 2021, në ligjin e statutit u bë një parashikim i tillë që thuhet “brenda afatit njëmuor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, Këshillat emërojnë magjistratët... etj.”, pra Këshilli ka një muaj kohë që të bëjë të gjithë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe të figurës dhe pastaj bën emërimin dhe ky një muaj fillon nga momenti i diplomimit, nga momenti i shpalljes së listës. Ju në projektvendim edhe këtë një muaj e keni përfshirë për trajtim financiar.

Të shpjegoj ndryshimin e situatave.

Në vitin 2022 kur u zbatua ndryshimi i ligjit të 2021, nuk pati padi nga magjistratët, nga gjyqtarët e sapoemëruar për arsye sepse ne arritëm që t’i bënim brenda muajit korrik të gjithë. Sivjet kemi tejkalim për shkak të procedurave, i kemi bërë në tetor. Para vitit 2021, po kështu kishim vonesa por ky parashikimi i nenit 35, pika 4 nuk ka ekzistuar dhe me vendime gjyqësore, kandidatët për gjyqtarë (të diplomuarit) morën edhe përfitimet e tyre që do t’i merrnin nëse, vlerën e pagës bruto, do e merrnin nëse ata do të ushtronin normalisht detyrën. Ky një muaj që Këshilli zhvillon procedurat pse është përfshirë sepse nëse paga fillon nga momenti që ti ke marrë statusin e magjistratit, nënkupton që ligji vetë e ka parashikuar që brenda këtij një muaji ti nuk e ke statusin dhe nuk e parashikon trajtimin financiar.

Unë parimisht jam dakord. Që ta kuptosh edhe logjikën, që për shkak të vonesave në procedura, nuk kemi pse ne justifikojmë ecurinë e proceseve gjyqësore, që ata të marrin (sepse edhe Këshilli ngarkohet me më shumë shpenzime), por ata duhet të marrin, duhet të kenë trajtimin financiar (nuk do përdoret ndonjë term “dëmshpërblim” ose “pagë” këtu për të qenë më të kujdesshëm). Trajtimin financiar, në vlerësimin tim nga 1 gushti e tej. Por nuk e kuptoj pse duhet edhe për muajin korrik?! Kur muaji korrik është muaj në dispozicion të Këshillit për të bërë procedurat e të diplomuarve. Jo pa qëllim u bë ndryshimi i ligjit.

Ilir Rusi: Faleminderit për ndërhyrjen zonja Ukperaj!

Për më tej fjalën zoti Haxhiu!

Xhevdet Haxhiu: Duke qenë se relacioni i paraqitur në Komision është përgatitur bazuar në një memo të përgatitur nga Departamenti i Shërbimeve Juridike, të them të vërtetën, në dijeninë time, nuk e kam atë informacionin e duhur në lidhje me vendimet gjyqësore para ndryshimeve dhe pas ndryshimit të ligjit 96. Kështu që unë kërkoj kohë që në bashkëpunim me departamentin të marrim një informacion më të plotë dhe ta paraqesim në seancën e radhës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Po zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Unë do të kërkoja që në materialet (kur të përfshihet në mbledhje plenare) të na vihen edhe kopje të vendimeve gjyqësore bashkëngjitur për të parë mënyrën se si e kanë trajtuar gjykatat para dhe pas ndryshimeve të ligjit.

Ilir Rusi: Po, zoti Haxhiu!

Xhevdet Haxhiu: Po, patjetër!

Informacioni radhën tjetër do jetë shumë më i plotë se sa sot.
Faleminderit!

Ilir Rusi: Duke iu referuar standardit të mbajtur nga ky Këshill sipas rastit kur kërkohet kohë nga relatori për të trajtuar çështje përkatëse më të thelluara dhe më të azhurnuara me aktualitetin, atëherë kjo çështje e këtij rendi dite mbetet e papërfunduar nga kjo mbledhje dhe do të shtyhet për një mbledhje të ardhshme.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.12.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi transferimin e një automjeti (autoveturë), në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:56 dhe mbaroi në orën 15:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Fatmira Luli* (anëtare)
3. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
4. *Ridvan Hado* (anëtar)
5. *Alban Toro* (anëtar)
6. *Marçela Shehu* (anëtare)
7. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
8. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes zonja *Irena Plaku* e cila u larguar pas trajtimit të çështjes së tretë të rendit të ditës.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 6. Valbona Bala, eksperte EWMI.*
- 7. BIRN.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi transferimin e një automjeti (autoveturë), në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi transferimin e një automjeti (autoveturë), në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni, gjatë këtij viti buxhetor KLGJ-ja ka marrë disa masa për shpërndarjen dhe rishpërndarje të automjeteve për të rregulluar situatën me mjete transporti në sistemin gjyqësor. Kështu që, para disa kohësh, nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në muajin nëntor, është paraqitur një kërkesë për t'u pajisur me një automjet të ri, për të plotësuar nevojat e saj.

Ju bëjmë me dije se Gjykata e Sarandës ka në pronësi vetëm një automjet tip Mercedes të vitit 2009 i cili është transferuar pranë kësaj gjykate në vitin 2017. Gjykata, referuar pozicionit gjeografik dhe gjendjes jo të mirë teknike të automjetit që ka në pronësi, kërkon pajisjen me një automjet të ri. Por në situatën që jemi, struktura përgjegjëse në KLGJ në pamundësi për një automjet të ri, vlerëson transferimin e një automjeti të përdorur, por në gjendje të mirë teknike.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të Këshillit, shqyrtimin dhe miratimin e transferimit të automjetit tip Audi, të vitit 2008, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Faleminderit për vëmendjen!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e këtij akti.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi transferimin e një automjeti (autoveturë), në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e transferimit të automjetit tip Audi, me targë AB 061 KG viti i prodhimit 2008, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.12.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...} dhe ish-magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor, relatore znj. Marçela Shehu.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:56 dhe mbaroi në orën 15:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Alban Toro | (anëtar) |
| 6. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Shënim: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes zonja *Irena Plaku* e cila u larguar pas trajtimit të çështjes së tretë të rendit të ditës.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Entela Dobi dhe Denisa Varfi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
6. *BIRN.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...} dhe ish-magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor, relatore znj. Marçela Shehu.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, dhe me një rend të përditësuar po vazhdojmë me pikën 6, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të

Shkallës së Parë {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor. Për më tej fjalën relatores zonjës Shehu. Njëkohësisht administrata të jetë gati me infrastrukturën për hedhjen e shortit.

(Paraprakisht, përpara se të fillonte mbledhja, anëtarët ranë dakord që objekti i këtij projektvendimi të shkurtohej dhe të hiqej fraza “dhe ish-magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}”).

Marçela Shehu: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Sikurse e cituat, Komisioni Disiplinor paraqet për diskutim mbledhjes plenare projektvendimin për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}.

Më datë 30.11.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me objekt:

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}.

2. Mbylljen e hetimit disiplinor ndaj ish-magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.

Pra kërkesa e Inspektorit, në fakt, ka dy kërkesa, por Këshillit do i duhet të disponojë vetëm për njëren nga kërkesat për caktimin e relatorit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, ndërsa për kërkesën e paraqitur për mbylljen e hetimit disiplinor, Këshilli nuk disponon më një vendim pasi është kompetencë e vetë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ndaj dhe në projektvendim, si në titull ashtu edhe në përmbajtje, citohet vetëm caktimi i relatorit për procedimin disiplinor ndaj magjistratit zotit {...}.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1,

shkronja “d” i Ligjit nr. 96/2016.

Ndërkohë, kërkesa për mbylljen e hetimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016 dhe në nenin 134 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit z. {...} të parashikuar nga neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndërsa, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka parashtruar dhe kërkesën për mbylljen e hetimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit {...}, për shkak të mbarimit të statusit të tij.

Lidhur me procedurën.

Në kushtet kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, inicion një procedurë individuale administrative në Këshill, në referim të nenit 63 të Ligjit nr. 115/2016, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit.

Lidhur me procedurën e shortit, Komisioni Disiplinor propozon që në short të përfshihen tre anëtarët e përhershëm të tij: znj. Marçela Shehu, z. Ridvan Hado dhe z. Ilir Rusi, në referim të nenit 16 të vendimit nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit Për miratimin e Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor” ku përcaktohet se: “Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë”.

Menjëherë pas caktimit me short të relatorit, nga Këshilli duhet të procedohet me caktimin e mbledhjes plenare të radhës, në të cilën Këshilli, mbi relacionin e përgatitur nga relatori, mund të vendosë mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të Ligjit 96/2016 ose caktimin e datës së seancës dëgjimore sipas nenit 138/2 të këtij ligji.

Nga sa u parashtrua më sipër, bazuar në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 138 e vijues të Ligjit nr. 96/2016

“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Komisioni Disiplinor i propozon mbledhjes plenare, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 04/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ju faleminderit zonja Shehu!

Sikundër u theksua edhe nga relatorja, shqyrtimi i kësaj pike të rendit të ditës do vazhdojë vetëm për magjistratin z. {...} dhe jo ndaj ish-magjistratit {...}.

Ftoj administratën të përgatisë hedhjen e shortit.

Procedura e hedhjes së shortit si vijon:

Në një enë vendosen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Marçela Shehu, z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Relator për procedimin disiplinor nr.4/2023 përzgjidhet zoti Ridvan Hado.

Ilir Rusi: Ju faleminderit!

Mund të largoheni.

Pas hedhjes së shortit, ka diskutime mbi përmbajtjen e këtij projekt-akti?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë vazhdojmë me votimin e këtij projekt-akti, duke bërë edhe përditësimin në lidhje me relatorin përkatës.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ridvan Hado, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}.

2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, sipas rendit të ditës, të përditësuar, çështjet të cilat do jenë për shqyrtim në vijim, për shkak të karakterit të tyre duhet të gjykohen me dyer të mbyllura. Kështu që ndërpritet komunikimi me të tretët dhe do vazhdojë kjo mbledhje me dyer të mbyllura.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor